



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

U R D H Ë R

Nr. 318, datë 25. 3.2014

PËR

**KRIJIMIN E BORDIT TË AUTOMATIZIMIT PËR
IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË SISTEMEVE TË MENAXHIMIT TË
BURIMEVE TË MBROJTJES NË FA.**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 19, pika 2 të Ligjit Nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejtimit Strategjik Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar:

URDHËROJ:

1. Të ngrihet Bordi i Automatizimit, për implementimin e programit, për sistemin e menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në FASH, me përbërje si më poshtë:

➤ Drejtori i Përgjithshëm i Standarteve të NATO-s dhe Modernizimit	Kryetar
Drejtori i Automatizimit dhe Inovacionit	Anëtar
Drejtori i Financave	Anëtar
Specialist në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve	Anëtar
Drejtori i J1 në SHP	Anëtar
Drejtori i J2 në SHP	Anëtar
Drejtori i J4 në SHP	Anëtar
Drejtori i J6 në SHP	Anëtar
Komandanti i ASNI	Anëtar
Komandanti i Qendrës së Personelit dhe Rekrutimit	Anëtar
Komandanti i Qendrës së Menaxhimit të Materialeve	Anëtar
Specialist në Drejtorinë e Automatizimit dhe Inovacionit	Sekretar

2. Bordi të monitorojë procesin për programim të sistemeve të menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në FASH, dhe të bëjë rekomandimet përkatëse për miratim nga Ministri i Mbrojtjes.
3. Bordi të përgatisë raport 6-mujor për Ministrin e Mbrojtjes, mbi ecurinë e procesit për implementimin e programit të sistemeve të menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në FASH.
4. Të ndjekë ecurinë e implementimit të sistemeve të menaxhimit të burimeve të mbrojtjes, duke përcaktuar prioritet, radhën e punës si dhe masat e nevojshme administrative e ligjore me qëllim shmangien e pengesave dhe rreziqet për implementim.

5. Të ndjekë ecurinë e implementimit të sistemeve të menaxhimit të burimeve të mbrojtjes në përputhje me Direktivën dhe urdhrin të Ministrit të Mbrojtjes si dhe vendimit të Bordit të Modernizimit.
6. Të shqyrtojë propozimet për përmirësimet e mundshme në bazën ligjore e nënligjore dhe t'i paraqesë Ministrit të Mbrojtjes, rekomandimet përkatëse.
7. Të kërkojë informacion çdo muaj, për ecurinë e zbatimit të projektit, si dhe të detyrimeve që kanë Drejtoritë në MM/SHP, komandat, njësitë përkatëse sipas planit të implementimit të këtij programi.
8. Të mbikëqyrë menaxhimin teknik të ecurisë së implementimit të pajisjeve harduerike dhe softuerike si dhe të japë rekomandimet përkatëse, për përmirësimet apo ndryshimet që dalin si domosdoshmëri gjatë zbatimit të projektit.
9. Bordi mbledhet jo më pak se një herë në 3-muaj. Rendi i ditës të përfshijë diskutimin e çështjeve dhe caktimin e detyrave me afate, për të siguruar zbatimin në kohë, të urdhrin të Ministrit të Mbrojtjes, lidhur me implementimin e programit të "Sistemeve të menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes".
10. Sekretari i Bordit, mban protokollin e mbledhjes dhe merr masa për njoftimin e anëtarëve të bordit për mbledhjen e radhës. Dokumentacioni i Bordit mbahet në dosje të veçantë dhe dorëzohet në Sekretarinë e (SHP/MM) çdo vit. Protokollet e mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretari i Bordit.
11. Në varësi të tematikave të mbledhjeve të Bordit, Kryetari fton të marrin pjesë edhe specialistë të fushave të veçanta si dhe përfaqësues të CUBIC.
12. Komandat e Forcave, Njësite, Drejtoritë në MM/SHP janë të detyruar të japin informacion zyrtar, sipas kërkesës që bën kryetari i Bordit, si dhe vetë komandat e njësitë kur e vlerësojnë të nevojshme.
13. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri Kryetari i Bordit Drejtues për implementimin e programit të "Sistemet të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në FASH".
14. Ndjek zbatimin e Urdhrit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe Sekretari i Përgjithshëm, në Ministrinë e Mbrojtjes.
15. Ky Urdhër shfuqizon Urdhrin Nr. 364, datë 26.02.2013 të Ministrit të Mbrojtjes.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

